

Integrimi – Suksesi përmes angazhimit vetjak!

Ju do të mbështeteni nga punëdhënësi!

Kantoni i qytetit të Bazelit nxit integrimit tuaj me kurse të gjermanishtes dhe të integrimit, ndërmjetësime informacioni, oferta të këshillimit, përshëndetje për të ardhurit e ri, mundësi takimi dhe oferta të aktiviteteve të lira. Ju jeni përzemërsisht të ftuar që të përfitoni nga këto oferta!

Shanse më të mira në karrierë përmes njohurive të mira të gjermanishtes!

Informacionet mbi kurset e gjermanishtes dhe ato të integrimit mund t'i gjeni:

- Në fletëpalosjen „Gjermanisht në regjionin Bazelit“
- Në faqen me informacione mbi integrimin: www.integration-bsbl.ch
- Gjatë këshillimit individual dhe falas për kursin e gjermanishtes pranë Këshillimit për të huaj të GGG, Tel. 061 206 92 22

Me pjesëmarrjen tuaj në projektin falas „Njohuri më të mira të gjermanishtes përmes takimeve“ keni mundësinë të komunikoni aktivisht me një person gjermanishtfolës dhe të mësoni më tepër mbi mentalitetin zviceran. Kontaktoni BENEVOL Bazel, Tel. 061 261 74 24

Përditshmëri e lehtësuar përmes njohjes së të drejtave dhe detyrimeve!

Në Zvicër janë burri dhe gruaja ligjërisht të barabartë. Shanset e barabarta vlejné për të gjithë. Racizmi, sjellja diskriminuese dhe dhuna e çdo lloji nuk do të tolerohen, as në shtëpi e as në vendin e punës.

Informohuni me kohë mbi rregullat e jetës profesionale dhe përditshmërisë si dhe mbi përmbajtjen e procesit integrues të Bazelit në mënyrë që të parandaloni vështirësitë dhe keqkuptimet.

Udhëzime mbi ligjin e integrimit i gjeni në faqen www.welcome-to-basel.bs.ch

Përfitoni falas nga Këshillimi juridik dhe social për migrantet dhe migrantët në 17 gjuhë. Këshillimi për të huaj i GGG, Eulerstrasse 26, 4051 Basel, i përgjigjet pyetjeve rreth këtyre temave:

- Ligji i Bazelit për integrim
- Të drejtat dhe detyrimet në vend pune
- E drejta e qirasë
- Sigurimet shoqërore
- Tatimi
- Edukimi dhe jeta familjare
- Të drejtat dhe detyrimet në shkollë
- Sjellja me mentalitetin zviceran
- Dhe shumë pyetje tjera.

Informacione shtesë mund të gjeni në faqen: www.auslaenderberatung-basel.ch

Nëse keni pyetje drejtohuni pranë vend këshillimit për të huaj të GGG: Tel. 061 206 92 22

basel

arbeitgeber

**Gewerbeverband
Basel-Stadt**



handelskammer beider basel

VERBAND DER INDUSTRIE-, HANDELS- UND DIENST-
LEISTUNGSFIRMEN IN BASEL-STADT UND BASELSTADT

Ausländerberatung der GGG

Fillim i avancuar përmes informacioneve të vlefshme!

Ju jeni përzemërsisht të ftuar në përshëndetjet mirë ardhëse për të ardhurit e ri si dhe në mbrëmje tjera informative. Informacione më të hollësishme mund të gjeni në faqen: www.integration-bsbl.ch

Material informativ mbi leje qëndrimet, bashkimin familjar, kurset e gjermanishtes, hedhjen e mbeturinave, aktivitetet e kohës së lirë si dhe shumë tema tjera mund ti gjeni në qendrën e klientëve të entit të banorëve, Spiegelgasse 6, 4051 Basel (Nga e hëna deri të premten nga ora 09.:00 deri në orën 17.30, të shtunave nga ora 09:00 deri në ora 14:00).

Kontakte pasuruese përmes participimit

Një anëtarësim në një klub sportiv apo në një shoqatë u hap portat drejt popullatës zvicerane!

Informacionet mbi shoqatat dhe mundësitë sportive mund t' gjeni në faqet:

www.mybasel.ch, www.sport-bs.ch, www.riehen.ch, www.bettingen.ch

Në qendrat e lagjes dhe të takimeve ofrohen shumë aktivitete kulturore, në të cilat jeni të mirëseardhur.

Ofertat dhe kalendarin e aktiviteteve mund ta gjeni në faqen:

www.quartiertreffpunkte-basel.ch, www.verkehrsvereinriehen.ch

basel

arbeitgeber

Gewerbeverband
Basel-Stadt



handelskammer beider basel



VERBAND DER INDUSTRIE-, HANDELS- UND DIENST-
LEISTUNGSFIRMEN IN BASEL-STADT UND BASELSTADT

Ausländerberatung der GGG